



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 74 / 2024

Datë: 02 / 04 / 2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 92 dhe 93 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në përputhje me nenin 8 dhe nenin 13 (paragrafi 2, nën paragrafi 2.3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

#### VENDIM

1. Znj. Agnesa Hasani, emërohet Asistente Administrative e Ministres së Drejtësisë.
2. E emëruara nga pika 1 e këtij vendimi ushtron përgjegjësitë e saj në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarës në pikën 1 të këtij vendimi fillon me datë 02/04/2024 dhe zgjatë deri kur pushon mandati i Ministres së Drejtësisë, përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër.
4. Të ardhurat personale të të emëruarës nga pika 1 e këtij vendimi do të paguhen në vlerën e koeficientit 5.4, klasa C17, sipas legjislacionit përkatës për pagat në sektorin publik.
5. Obligohet Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Divizioni për Burime Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Albulena HAXHIU

Ministria e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- Të emëruarës znj. Agnesa Hasani;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa; dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.